



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1085 Prot.

Roskovec, më 20.02.2024

VENDIM

NR. 13 .DATË 19.02.2024

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË VKB NR.07 DATË 30.01.2024 "PËR
MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE NGA PROGRAMI PËRMIRËSIMI I
KUSHTEVE TË BANIMIT PËR KOMUNITETE TË VARFRA DHE TË
PAFAVORIZUARA**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, neni 24, Ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar; VKM-së Nr.454, datë 03.07.2019 "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", Udhëzimit Nr. 31, të Ministrisë së Financave, datë 18.11.2019, "Për procedurat standarte të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit"; Vendimit nr. 384, datë 12.06.2019, "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të alateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetqeverisjes vendore"; VKB Nr.07 datë 30.01.2024 " Për miratimin e listës së përfituesve nga programi përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara"; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Miratimin e një shtese dhe ndryshim në VKB Nr.07 datë 30.01.2024 " Për miratimin e listës së përfituesve nga programi përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara", konkretisht :

-Zëvendësohet në listën emërore Z.Xhevit Nazëraj me Z.Astrit Cenka,sipas lidhjes nr.1.

- 2- Ngarkohet Komisioni i strehimit, për kryerjen e procedurave përkatëse dhe zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

